

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
 Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
 Ministry of Finance
 Arkiva - Arhiva - Archive

Masia Org. 02/Kon
 Org. Jedin. Nr. Prot. 2839-1/2023
 Org. Unit Prot. No.

Nr. i faqëve 2-9
 Broj stranica Datum 14.12.2023
 No. pages Date

Dalëse PRISHTINE/A



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
 Ministry of Finance, Labour and Transfers*

Për:	Ferit Idrizi , Kryetar i Komunës së Vushtrrisë
	Melihate Basholli-Latifi , Kryesuese e Kuvendit të Komunës
Kopje:	Elbert Krasniqi , Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal Jeton Qela , ud. Sekretare e Përgjithshme, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Përmes:	Avni Zogiani , Zv. Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve Enis Spahiu , ud. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Nga:	Bora Duli , ud. Drejtoreshë e Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Zyrtarët përgjegjës:	Referencë: 507/2023
1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Razije Murtezaj , Zyrtare Ligjore, Departamenti Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
2. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Vehap Hashani , Zyrtar i Lartë Ligjor, Departamenti i Tatimit në Pronë, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Vushtrrisë
Lloji i aktit:	Vendim



I nderuari Kryetar z. Idrizi,
E nderuara Kryesuese znj. Basholli-Latifi,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

<i>Vendim Nr. 263/23 për faljen e obligimeve në tatimin e pronës së paluajtshme</i>
<i>I miratuar më datë 30.11.2023</i>
<i>I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 07.12.2023</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më 11.12.2023</i>

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si "**Ministria**"), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërm të Komunës së Vushtrrisë, jep konstatimet ligjore të mëposhtme:

1. Komuna e Vushtrrisë, me anë të këtij akti që është subjekt i shqyrtimit, synon faljen e tatimit në pronë për vitin 2023.
2. Si pikë e parë, dhe për qëllime të këtij vlerësimi është me rëndësi të theksohet se, neni 5 Falja e Tatimit në Pronë për Vitin Tatimor 2023 të Ligjit Nr.08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për faljen e tatimit në pronë për të gjithë tatimpaguesit lejohet deri në lartësinë e faturës së tatimit në pronë për vitin 2023, por jo më shumë se njëqind (100) euro në pajtim me dispozitat këtij kapitulli.
3. Andaj, lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese me datën 22.11.2023 ka vendosur që dispozitat ligjore për faljen e tatimit në pronë në vlerë prej 100 euro komunat mundën të nxjerrin vendim për faljen e tatimit, që afati i mbetur pesëmbëdhjetë (15) ditor nga afati tridhjetë (30) ditor i përcaktuar me nenin 11/B (Shuma e faljes së tatimit në pronë për pronën e paluajtshme) të nenit 5 të Ligjit Nr.08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, fillon të rrjedhë nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi, si vijon:

Neni 11/C
Kufizimi

Falja tatimore e parashikuar me këtë kapitull zbatohet vetëm për vitin tatimor 2023 dhe nuk do të zbatohet për asnjë vit tjetër tatimor.

Neni 11/Ç
Administrimi

1. Zbatimi i këtij kapitulli mbetet përgjegjësi e çdo komune përgjegjëse për administrimin e procesit të tatimit në pronë për pronat e paluajtshme që ndodhen brenda territorit të komunës.



2. Ministria përgjegjëse për financa nxjerr vendime që mund të jenë të nevojshme për zbatimin e këtij kapitulli.

4. Në vijim, me anë të këtij akti, Komunës së Vushtrrisë i lejohet nxjerrja e vendimit në lidhje me procedurat për faljen e tatimit në pronë për vitin 2023.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Vushtrrisë dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Enis Spahiu, U.d. Sekretar i Përgjithshëm në MFPT	
Kopje:	Kryetar i Komunës së Vushtrrisë Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmes:	Jeton Qela, U.d. Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	<i>Jeton Qela</i>
Nga:	Besim Myrtezani, U.d. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 06.12.2023 Nr. 020-957
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Ministri të Linjës Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
	2. Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse Gafur Sllamniku, Zyrtar i Lartë për Monitorim të Komunave	
Lënda:	Shkresë përcjellëse	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Sekretar,


Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar Vendimin Nr. 263/23 për faljen e obligimeve në tatimin e pronës së paluajtshme, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, dhe e nënshkruar nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 3, të Rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK)-Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Vendimin Nr. 263/23 për faljen e obligimeve në tatimin e pronës së paluajtshme

I miratuar më datë: 30.12.2023

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 07.12.2023



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtri

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 2, shkronja "d", nenit 40, paragrafi 2, pika "c" të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 11 B të Ligjit nr. 03/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Pajunjtshme, Aktgjykimin të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr.ref.2296/23,pika 49 i datë 23.11.2023, si dhe në bazë të nenit 19, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4. i Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 30 nëntor 2023 merr këtë:

VENDIM

PËR FALJEN E OBLIGIMEVE NË TATIMIN E PRONËS SË PALUAFTSIME

1. Me këtë vendim falen obligimet nga tatimi në pronën e pajunjtshëm në Komunën e Vushtrisë për ekonominë familjare dhe bizneset në vlerë deri në njëqind (100 E) euro për vitin 2023.
2. Falja e obligimeve të cekura në pikën një (1) të këtij vendim, aprovohet pas publikimit të Aktgjykimin të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, me të cilin iu jepet e drejta kuvend komunale, për faljen e këtyre obligimeve, si dhe duke marr për bazë gjendje e renduar ekonomiko-sociale të qytetarëve të Komunës së Vushtrisë, si rezultat rritjes së çmimeve në treg-inflacionit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa si dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.
4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit